



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 11.7.2024

Nr: 78

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË LEZHË, ME KANDIDATIN
NGA LISTA SHUMEMËRORE E “PARTISË SOCIALDEMOKRATE TË SHQIPËRISË”,
Z. ERVIN VLASH COLI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 10152 prot., datë 10.6.2024, Këshilli i Bashkisë Lezhë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Aris Mehmet Mema, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialdemokrate e Shqipërisë”.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e “Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë”, për Këshillin e Bashkisë Lezhë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 17, z. Ervin Vlash Coli.

Me shkresën nr. 1599, prot., datë 13.06.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë z. Ervin Vlash Coli, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet

Data: 11.7.2024 Nr: 78
Ora: 12:00



“Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë, me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë”, z. Ervin Vlash Coli”

pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore të subjektit “Partia Socialdemokrate e Shqipërisë”, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër LE-PSD-4946_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Ervin Vlash Coli, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, me shkresën nr. 1749 prot., datë 28.06.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile, dhe me shkresën nr.1748 prot., datë 28.06.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, për z. Ervin Vlash Coli.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar z. Ervin Vlash Coli, në Këshillin e Bashkisë Lezhë.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 11132/1 prot., datë 05.07.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Ervin Vlash Coli, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Ervin Vlash Coli, në Këshillin e Bashkisë Lezhë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë, me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë, z. Ervin Vlash Coli.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Iirjan CELIBASHI